



Pranuar / Doretuar Priljenjati/Priljenjati Received/Deliverty	04.05.2023	3	viti god year
Organ /Njesta Organ /Jedinstva Org./Unit	SIKAMBHEK	4050/2023	114



Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.462/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-Kryetar, Arben Mehmeti dhe Ardita Haxhnikaj-Demi anëtarë, me Çlirim Zeka - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.462/2023 të datës 06.03.2023 të parashtruar nga ankuesi, të cilin me autorizim e përfaqëson Avokat me adresë rr."Mulla Nura" pn. Komuna Suharekës, kundër organit të punësimit, Komunës së Suharekës në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim, me datë 04.05.2023, mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejueshme ankesa A.nr.462/2023 e datës 06.03.2023, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në pozitën " Zyrtar për Buxhet dhe Financa" në Drejtorinë për Arsim në Komunën e Suharekës sipas Akt Emërimit 01-112-33111-Z të datës 11.06.2021, me datë 02.03.2023 ka parashtruar ankesë përmesë postës e cila është protokolluar me numër 2355/2023 me datë 06.03.2023, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me pretendimin ankimor duke u bazuar sipas Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, dhe Ligjit Nr. 03/L-147 për pagat e Nëpunësve Civil dhe Rregullores 33/12 për Shtesat në pagë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil për shkak të kushteve specifike të punës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës bazuar në dispozitat e Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregullores Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur

Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, më datë 17.03.2023 me numër protokolli 2789/2023 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë tek Komuna e Suharekës, ndërsa Këshilli më datë 27.03.2023, me numër protokolli 3002/2023, ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Suharekës me shkresat e bashkangjitura.

Kryetari i Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 18.04.2023 ka nxjerr Vendim VK.nr./2023 me të cilin ka bërë zgjatjen e afatit për vendosjen e ankesës së ankuesit për dhjetë (10) ditë pune.

**Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova:** Ankesën me nr.protokolli 2355/2023 të datës 06.03.2023 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; E-mail nga B.B. për [ankesa.kpmsk@rks-gov.net](mailto:ankesa.kpmsk@rks-gov.net) i datës 17.03.2023; Letërnjoftim i J.T.; Autorizim nga J.T. për përfaqësuesin e autorizuar Avokat B.B.; Lista e pagave; Akt Emërim i J.T. me numër 01-Nr-42 i datës 28.12.2011; Kërkesë me numër protokolli 01-104-23346 i datës 15.06.2020; Pliko e datës 02.03.2023; Kërkesë për përgjigje në ankesë me numër protokolli 2789/2023 i datës 17.03.2023; Përgjigje në ankesë me numër protokolli 3002/2023 i datës 27.03.2023; Akt Emërim i J.T. me numër 01-112-33111-Z i datës 11.06.2021; Përshkrimi i detyrave të punës për pozitën "Inspektor i Tregut" i datës 12.12.2012; Konkurs me Nr. Reference RN00006746 i datës 22.04.2021; Aktvendim me numër 01-Nr-1416 i datës 17.08.2010; E-mail nga A.H. për C.Z. i datës 19.04.2023; E-mail nga C.Z. për A.H. i datës 19.04.2023; Kërkesë me numër 01-Nr-104-28719 i datës 10.07.2020; E-mail nga C.Z. për A.H. i datës 19.04.2023; Kontrata e Punës e J.T. me numër 01-Nr-62/09 i datës 31.12.2008; Diplomë e J.T. Shkolla e lart ekonomike komerciale me numër Nr.01-262/144 e datës 15.12.1990; Diplomë nga Kolegji Biznesi e J.T. me numër Nr. 79/18 i datës 16.05.2018; Vendim me numër VK/2023 me numër protokolli 3643/2023 i datës 18.04.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pas shqyrtimit dhe analizimit të shkresave të lëndës të parashtruara nga palët në procedurë, konstatoi se ankesa e ankuesit është e palejuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankuesi fillimisht ka qenë i punësuar në pozitën "Inspektor i Tregut" në Drejtorinë për Administratë dhe Inspektion në Komunën e Suharekës sipas Akt Emërimit të datës 28.12.2011. Ndërsa duke u bazuar në shkresat e lëndës është konstatuar se ankuesi aktualisht është i punësuar në pozitën "Zyrtar për Buxhet dhe Financa" në Drejtorinë për Arsim në Komunën e Suharekës sipas Akt Emërimit 01-112-33111-Z të datës 11.06.2021. I njëjti i është drejtuar me kërkesë me numër protokolli 01-104-23346 me datë 15.06.2020 Kryetarit të Komunës së Suharekës që ti mundësoj kompensimin e pagës shtesë mbi pagën bazë duke u bazuar në nenin 7 paragrafin 1 dhe nenin 10.A të Ligjit Nr. 04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut si dhe Rregulloren 33/12 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil. Ndërsa i njëjti nuk ka pranuar përgjigje lidhur me kërkesën e lartcekur nga organi i punësimit.

Ankuesi në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me pretendimin ankimor duke u bazuar sipas Ligjit Nr.04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut, dhe Ligjit Nr. 03/L-147 për pagat e

Nëpunësve Civil dhe Rregullores 33/12 për Shtesat në pagë dhe kompensimet tjera të nëpunësve civil për shkak të kushteve specifike të punës, që ti njihet e drejta e pagës shtesë mbi pagën bazë nga periudha 01.01.2009 e deri me datë 28.02.2023.

Kolegji i Këshillit, lidhur me pranueshmërinë e ankesës analizoi dispozitat e Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, i aplikueshëm në kohën e parashtrimit të ankesës në Këshill, përkatësisht neni 127 paragrafi 1 ku përcaktohet se: 1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ. 4. Ankesa kundrejt heshtjes administrative mund të parashtrohet jo më herët se shtatë (7) ditë dhe jo më vonë se dy (2) muaj pas skadimit të afatit për njoftimin e aktit administrativ, dhe rrjedhimisht duke marrë parasysh faktin se ankuesi i është drejtuar me kërkesë organit të punësimit Komunës së Suharekës që ti mundësoj kompensimin e pagës shtesë mbi pagën bazë duke u bazuar në neni 7 paragrafin 1 dhe nenin 10.A të Ligjit Nr. 04/L-186 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.03/L-181 për Inspektoratin dhe Mbikëqyrjen e Tregut si dhe Rregulloren 33/12 për shtesat në pagë dhe kompensime të tjera të nëpunësve civil, ku në bazë të shkresave të lëndës kërkesa e fundit drejtuar organit të punësimit figuron të jetë e datës 15.06.2020, si dhe duke u bazuar në përgjigjen zyrtare të datës 19.04.2023 të Menaxherit të Personelit në Komunën e Suharekës organi i punësimit ka dërguar kërkesën në MPB për sqarim dhe vlerësim të mëtutjeshëm ndërsa MPB deri më tani nuk ka kthyer përgjigje dhe se ankuesi ka qenë i njoftuar verbalisht nga Komuna e Suharekës. Në bazë të shkresave të lëndës konfirmohet se Komuna e Suharekës nuk i ka kthyer përgjigje lidhur me kërkesën e ankuesit. Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka konstatuar se ankesa me numër A.nr.462/2023 e parashtruar me datë 06.03.2023 është parashtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me dispozitat e Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ashtu sikurse edhe në kundërshtim me dispozitat e ligjit në fuqi, konkretisht nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, sepse inicimi i procedimit administrativ konsiderohet se ka filluar me datë 15.06.2020, veprim ky i fundit sipas shkresave të lëndës kur ankuesi i është drejtuar organit të punësimit dhe se nga data 15.06.2020 deri me datë 06.03.2023 kur ankuesi i është drejtuar me ankesë Këshillit, kanë kaluar më tepër se dy (2) vite e nëntë (9) muaj. Andaj në këtë kuptim, Kolegji i Këshillit konstaton se ankesa A.nr. 462/2023 e datës 06.03.2023 për shkak të parashtrimit jashtë afatit ligjor nuk është e pranueshme në kuptim të nenit 129 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 ndërlidhur me nenin 127 paragrafi 4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Bazuar në të gjeturat si më lartë, Kolegji pas analizimit dhe shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.


Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë/Departamenti për Çështje Administrativ brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.



KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
Lënda me numër A.nr.462/2023

Çlirim ZEKA

  
Procesmbajtës



Eshref SHABANI

Kryetar i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet**

- Përfaqësuesit të autorizuar të ankuesit,
- Kryetarit të Komunës së Suharekës;
- Udhëheqësit të Personelit të Komunës së Suharekës; dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.

